

VENDIM
Nr. 28, datë 1.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha kryetare;

Marsida Xhaferllari anëtare;

Fiona Papajorgji anëtare;

Elsa Toska anëtare;

Sonila Bejtja anëtare;

Sandër Beci anëtar;

Ilir Toska anëtar;

Altin Binaj anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 4 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Albert Xhani

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

AVOKATURA E SHTETIT,

Shoqëritë Huamarrëse në Administrim,

Zyra e Përmbarrimit Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altin Binaj, shqyrtoi pretendimet e paraqitura nga kërkuesi Albert Xhani, që kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Shoqërive Huamarrëse në Administrim, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, konstatoi se Zyra e Përmbarrimit Tiranë nuk ka pretendime dhe parashtrime, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Albert Xhani (*kërkuesi*) dhe shoqëria “Vefa Holding” sh.p.k. në datën 2.12.1996 kanë lidhur 14 kontrata shitjeje, përmes të cilave kërkuesi i ka shitur kësaj shoqërie disa objekte të ndodhura në qytetin e Përmetit, për një çmim total në vlerën 11.960.000 USD, çmim ky që sipas përshkrimit në ato kontrata është likuiduar totalisht jashtë zyrës së noterit.

2. Me ligjin nr. 8188, datë 23.1.1997, “Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes” huamarrja e organizuar në bazë të skemave piramidale është shpallur e paligjshme, ndërkohë që me ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë

jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar janë vendosur nën kontroll financiar dhe administrim të detyruar subjekte të këtij ligji, ndër to dhe shoqëria “Vefa Holding” sh.p.k. (në vijim “shoqëria nën administrim”).

3. Në vitin 2001 shoqëria nën administrim ka ngritur padi kundër kërkuessit dhe bashkëshortes së tij me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të 13 kontratave të shitjes të lidhura në datën 2.12.1996 (me çmim total 11.160.000 USD) dhe kthimin e shumës 7.828.811 USD, bazuar në ligjin nr. 8472, datë 8.4.1999, “Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë dhe juridikë nga shitja e pasurisë apo transaksionet e pronësisë” (*ligji nr. 8472/1999*) dhe nenin 92, shkronja “b”, të Kodit Civil, me pretendimin se ishin kryer për të mashtruar ligjin, në rrethanat kur çmimi i shitjes ka qenë disa herë më i lartë sesa vlera e objekteve të hipotekuara (3.331.189 USD).

4. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë Përmet, me vendimin nr. 289, datë 1.10.2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se në legjislacionin shqiptar nuk kishte asnjë dispozitë, e cila për efekt të çmimit të papërshtatshëm (në qoftë se do të konsiderohet i tillë, duke eliminuar lirinë kontraktore të palëve) të përbënte shkak për pavlefshmërinë e veprimit juridik, ndërkohë që në gjykimin e çështjes nuk u provua që palët të kenë vepruar në mashtrim të ligjit.

5. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, mbi ankimin e shoqërisë nën administrim, me vendimin nr. 247, datë 28.5.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet. Në këtë rast, gjykata e apelit, ndërsa ka gjetur të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, ka mbajtur në konsideratë edhe se dispozita ligjore mbi të cilën bazohet padia, neni 3 i ligjit nr. 8472/1999, ishte shfuqizuar si antikushtetuese me vendimin nr. 40, datë 11.3.2002, të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

6. Mbi rekursin e shoqërisë nën administrim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

7. Gjithashtu, nga materialet e dosjes gjyqësore del se, mbi të njëjtin shkak dhe bazë ligjore, shoqëria nën administrim i është drejtuar përsëri Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet me padi me objekt pavlefshmërinë e një kontrate tjetër shitjeje të datës 2.12.1996 (me çmim 1.600.000 USD, për objektin “Pularia” të ndodhur në qytetin e Përmetit) dhe kthimin e shumës 1.563.250 USD, dhe të paditur kërkuessin dhe bashkëshorten e tij. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 166, datë 7.5.2002, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë.

8. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim shoqëria nën administrim dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 440, datë 1.11.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

9. Në bazë të rekursit të ushtruar nga shoqëria nën administrim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1318, datë 21.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

10. Ndërkohë, administratorët e shoqërisë nën administrim, me vendimin nr. 392, datë 9.7.2004, mbështetur në ligjin nr. 8471/1999, “Për nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” (*ligji nr. 8471/1999*), kanë shpallur kërkuessin debitor për shumën 5.100.000 USD, me arsyetimin se kjo shumë rezultonte e tërhequr prej tij në llogarinë e shoqërisë “Vefa” sh.p.k. (*regjistruar në datën 20.3.1996, me ortak shoqërinë “Vefa Holding” sh.p.k. dhe shoqërinë “Plus” sh.p.k., kjo e fundit fillimisht me ortak të vetëm kërkuessin*) në Bankën Kombëtare Tregtare në datën 27.12.1996, ndërsa nuk dokumentohej shkaku i pagesës. Ky vendim përbën titull ekzekutiv sipas ligjit nr. 8471/1999.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 132, datë 4.2.2005, ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për titullin ekzekutiv të administratorëve të shoqërisë nën administrim.

12. Zyra e Përmbarrimit Tiranë, me aktin “Lajmërim për ekzekutim vullnetar” nr. 691 prot., datë 4.3.2005, ka njoftuar kërkuesin për të bërë ekzekutimin vullnetar brenda 10 ditëve nga marrja dijani. Për lajmërimin kërkuesi ka marrë dijani në datën 29.3.2005.

13. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimin e administratorëve të shoqërisë nën administrim, në datën 1.4.2005, mbështetur në nenet 610 e 614 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), në nenin 8, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 8471/1999 dhe nenin 7, pika 7.3., të ligjit nr. 8472/1999, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Deklarimin të pavlefshëm si titull ekzekutiv të vendimit nr. 392, datë 9.7.2004, të administratorëve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k. në administrim, si dhe pezullimin e ekzekutimit të tij.”*. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.1.2006, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes deri në zgjidhjen e çështjes penale të filluar ndaj kërkuesit.

14. Pas një kallëzimi nga administratorët e shoqërisë nën administrim, ndaj kërkuesit ka nisur një procedim penal për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Kërkuesi është akuzuar për këtë veprë penale, ndërsa fakti penal i atribuuar atij lidhet me kryerjen e disa transaksioneve, si shitblerjen e kuotave të një shoqërie tregtare, ashtu edhe shitblerjen e pasurive të paluajtshme me shoqërinë nën administrim, si dhe me shtetasin V.A (ortaku i vetëm i shoqërisë nën administrim). Çështja penale në ngarkim të kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1292, datë 28.12.2005, ka vendosur deklarin e tij të pafajshëm, ndërsa ka arritur në përfundimin se në të gjitha veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohej. Në veçanti, sa u përket transaksioneve të kërkuesit me shoqërinë nën administrim, gjykata ka arsyetuar se ato datojnë para datës 23.1.1997, periudhë në të cilën, bazuar në ligjin nr. 8202, datë 23.7.1997, “Për amnistinë”, përjashtohet ndjekja penale për veprën që akuzohej kërkuesi. Po ashtu, gjykata ka arsyetuar se kërkuesi akuzohej për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, në një kohë që ndaj tij nuk kishte asnjë vendim gjyqësor për deklarin fajtor për kryerjen e ndonjë veprë penale. Gjithashtu, në aspektin e veprimeve të kryera nga kërkuesi, ato janë veprime normale e të rregullta midis ortakëve të një shoqërie dhe kontratat e shitblerjes, që përbëjnë veprime juridiko-civile, i nënshtrohen legjislacionit tregtar në fuqi për sa i përket rregullsisë, përmbajtjes dhe vlerësimit të tyre. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Tiranë, në rigjykimin e çështjes (pas prishjes së vendimit të parë nga Gjykata e Lartë), me vendimin nr. 533, datë 29.6.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se prokurori më i lartë ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit, duke mos përkrahur kështu ankimin e prokurorit më të ulët dhe duke hequr dorë prej këtij ankimi.

15. Pas përfundimit të çështjes penale, Gjykata e Apelit Tiranë ka rifilluar gjykimin e çështjes civile të pezulluar (*shih paragrafin 13 të këtij vendimi*). Në përfundim të shqyrtimit të padisë së kërkuesit për deklarin të pavlefshëm të titullit ekzekutiv, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 36, datë 10.3.2008, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë të paditësit Albert Xhani. Anulimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 392, datë 9.7.2004, të palës së paditur, administratorët e përbashkët të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, për shpalljes debitor të paditësit Albert Xhani.”*. Në vendimin e saj gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar pretendimin e administratorëve të shoqërisë nën administrim për parashkrimin e padisë, duke arsyetuar se ata nuk provuan zbatimin e detyrimit ligjor për njoftimin e vendimit të shpalljes debitor sipas kërkesave të nenit 6 të ligjit nr. 8471/1999, ndaj padia konsiderohej e paraqitur në afat. Lidhur me thelbin e çështjes, pra ekzistencën e detyrimit, gjykata e apelit ka arsyetuar se vlera prej 5.100.000 USD, e tërhequr nga kërkuesi, referuar proceseve civile të mëparshme mes palëve, si dhe vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, provohej se përfaqësonte një pjesë të çmimit të 14 kontratave të shitjes së datës 2.12.1996.

16. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur, administratorët e shoqërisë nën administrim. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2329 (436), datë 11.10.2012, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 36, datë 10.3.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me një tjetër trup gjykues.”*. Në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të pabazuar dhe pa hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm përfundimin e gjykatës së apelit për pabazueshmërinë e prapësimit të të paditurit për parashkrimin e padisë, duke lënë si detyrë verifikimin e pretendimit për njoftimin e kërkuarit sipas kërkesave të nenit 6 të ligjit nr. 8471/1999.

17. Në rigjykim, pasi ka administruar si prova kopje të dy gazetave me qarkullim kombëtar, që përmbanin edhe vendimin e administratorëve të shoqërisë nën administrim për shpalljen debitor të kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 56, datë 19.7.2013, ka rivendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë të paditësit Albert Xhani. Anulimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 392, datë 9.7.2004, të palës së paditur, administratorët e përbashkët të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, për shpalljes debitor të paditësit Albert Xhani.”*.

18. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs administratorët e shoqërisë nën administrim dhe Avokatura e Shtetit për të njëjtat shkaqe, konkretisht mosrespektimin e ligjit lidhur me parashkrimin e padisë dhe çmuarjen e provave. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 56, datë 19.7.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

19. Kërkuari në datën 9.3.2022 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës në datën 13.5.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 7.6.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. Kërkuari ka parashtruar, në mënyrë të përmblodhur, si më poshtë:

20.1 Gjykata duhet të shprehet *ex officio* nëse është një gjykatë e krijuar sipas ligjit, konkretisht sipas nenit 179 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, për t’u legjitimuar në shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura në kërkesë.

20.2 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

20.2.1 Parimit të sigurisë juridike, pasi mosmarrëveshja mes palëve është zgjidhur me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili është përfundimtar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, ka shkelur parimin *res judicata*, pasi ka prishur një vendim të po asaj gjykate të marrë 14 vjet më parë.

20.2.2 Së drejtës së pronësisë, të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi kërkuari është pronar i shumës 5.100.000 USD.

20.2.3 Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërimit kryesor nëse kërkuari ishte debitor kundrejt shoqërisë huamarrëse “Vefa Holding”. Gjithashtu, ajo nuk e përmend vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

20.2.4 Parimit të paanshmërisë, pasi çështja është shqyrtuar pas një periudhe shumë të gjatë dhe është zgjidhur në një kohë shumë të shkurtër, duke cenuar aspektin subjektiv të paanshmërisë.

Gjithashtu, në kushtet kur gjykata nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e njoftimit të parashikuara nga KPC-ja, është cenuar edhe aspekti objektiv.

20.2.5 *Së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi Gjkata e Lartë, duke zhvilluar gjykimin në dhomë këshillimi, nuk i ka krijuar mundësi kërkuarit të parashtrijë pretendimet e tij, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Çështja konkrete është specifike, pasi gjykohet në shkallë të parë në Gjykatën e Apelit dhe Gjkata e Lartë gjykon si shkallë e dytë. Ky argument duhet ta kishte bindur Gjykatën e Lartë për ta gjykuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjkata e Lartë ka kryer njoftimin vetëm me shpallje për kërkuarin, por kjo nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin.

20.2.6 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjkata e Lartë, duke gjykuar në dhomë këshillimi, nuk ka marrë në shqyrtim aktet e administruara në cilësinë e provës shkresore, akte që vërtetojnë se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm. Kërkuari është vënë në një situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykata ka vendosur vetëm mbi pretendimet e tyre, pa i dhënë mundësi kërkuarit të parashtrijë prapësime.

20.2.7 *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjkata e Lartë është konfirmuar joefektive për kohëzgjatjen e procedurës dhe Gjkata çështjen e shterimit duhet t'ia bashkëngjisë themelit të pretendimeve për shkelje të kohëzgjatjes së procedurës. Procesi gjyqësor ka filluar me depozitim të kërkesëpadisë nga kërkuari në datën 1.4.2005 dhe ka përfunduar në datën 23.11.2021 në Gjykatën e Lartë. Gjkata e Lartë nuk e ka gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm ligjor dhe nuk ka marrë masat e nevojshme për ta shqyrtuar atë sipas kohës së regjistrimit në atë gjykatë.

21. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke prapësuar si më poshtë:

21.1 *Pretendimet lidhur me ligjshmërinë dhe vlefshmërinë* e Gjykatës nuk kanë lidhje me objektin e kërkesës, për rrjedhojë nuk duhet të merren në shqyrtim.

21.2 *Pretendimi se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin res judicata është i gabuar* dhe në kundërshtim me përmbajtjen e këtij parimi. Procesi gjyqësor i referuar nuk trajton të njëjtën marrëdhënie juridike, madje nuk mbart të njëjtën natyrë juridike me çështjen konkrete. Në një vështrim *prima facie* kundrejt këtij konflikti gjyqësor shihet qartazi se e vetmja ngjashmëri me çështjen në shqyrtim janë palët. Në rastin konkret titulli ekzekutiv përcakton kthimin nga ana e kërkuarit të shumës që është debitor, detyrim i cili nuk lidhet me objektin e konfliktit të mëparshëm gjyqësor. Në rastin konkret detyrimet kanë lindur si pasojë e parashikimeve ligjore të nenit 8/2 të ligjit nr. 8471/1999 dhe të nenit 7, pika 7.3., të ligjit nr. 8472/1999.

21.3 *Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës* kërkuari nuk ka parashtruar argumente bindëse, por merr të mirëqena pretendimet e paraqitura në gjykatat e faktit, ndërkohë që çështja e tij, bashkë me pretendimet, është rrëzuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

21.4 *Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Kërkuari ka argumentuar se Gjkata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, pasi nuk i është referuar vendimit nr. 1319, datë 21.11.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në rastin konkret jo vetëm që vendimi nr. 1319, datë 21.11.2007, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk përbën *res judicata*, por Kolegji Administrativ ka konstatuar se kërkuari ka ushtruar të drejtën e ankimit tej afatit të caktuar me ligj dhe nuk e ka trajtuar çështjen në themel.

21.5 *Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë*, kërkuari nuk ka paraqitur argumente. Ai shprehet se vonesa në gjykim dhe marrja e vendimit në vetëm një seancë në dhomë këshillimi

tregojnë qartazi shkelje të parimit të paanshmërisë, por ndërkohë nuk e elaboron argumentin ku qëndron shkelja e këtij parimi.

21.6 Gjykata e Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Në parim është absurde të pretendohet se gjykimi në dhomë këshillimi, si proces, mund të përbëjë pengesë në raport me aksesin e subjektit në gjykatë. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë se përse Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore. Pretendimi se shqyrtimi i çështjes pas 8 vjetësh në dhomë këshillimi është shkelje, nuk gjen bazë ligjore në asnjë dispozitë dhe nuk mbart sens juridik. Kërkuesi nuk ka paraqitur argumente se pse çështja paraqitet komplekse në raport me objektin e saj. Natyra e çështjes konkrete nuk shfaqet komplekse, pasi nuk bazohet mbi disa pretendime të natyrave juridike të ndryshme dhe nuk u drejtohet shumë palëve.

21.7 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar. Sekretaria gjyqësore ka kryer njoftimin përkatës nëpërmjet shpalljes publike për zhvillimin e çështjes në dhomë këshillimi. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka vendosur duke u bazuar vetëm te pretendimet e njëres palë, është paragjykes, pasi pretendimet i shërbejnë gjykatës për dhënien e vendimit, por nuk mund të aludohet se ajo ka vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të njëres palë.

21.8 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar është i pabazuar, pasi kërkuesi në asnjë moment nuk ka pretenduar se nuk i është njoftuar rekursi, por ngre pretendime për paligjshmërinë e veprimeve të sekretarisë gjyqësore në raport me faktin se ka kryer vetëm njoftim publik për çështjen konkrete, ndërkohë që ligji është i qartë dhe parashikon se njoftimi për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi bëhet me shpallje publike.

21.9 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk është cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vonesa e gjykimit. Në raport me këtë fakt, subjekt më i cenuar ka qenë i padituri. Për më tepër, kërkuesi, në funksion të përsheptimit të gjykimit, nuk i ka përdorur të gjitha mjetet e mundshme procedurale që disponohen nga ligji.

22. **Subjekti i interesuar, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke prapësuar si më poshtë:

22.1 Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i përmbush standardet, është i bazuar në prova dhe ka respektuar ligjin material e procedural.

22.2 Për pretendimin e cenimit të barazisë së armëve, paraqitja e argumenteve të mbrojtjes është e barabartë për të gjitha palët kundërshtare.

22.3 Për pretendimin e tejzgjatjes së afatit të arsyeshëm ligjor të procesit gjyqësor, ligji nr. 8472/1999 ka përcaktuar Gjykatën e Apelit si shkallë të parë gjykimi për ankimin e debitorëve dhe në kohëzgjatjen e procesit ka ndikuar kalimi dy herë i çështjes në të gjitha shkallët e gjykimit.

23. **Subjekti i interesuar, Zyra e Përmbarimit Tiranë**, edhe pse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

24. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

25. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

26. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen konkrete objekt kundërshtimi dhe ka interes të drejtpërdrejtë.

27. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, pas përfundimit të procesit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjykata çmon se kërkuesi për pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të parimeve të sigurisë juridike, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të paanshmërisë, të së drejtës së aksesit, të së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Ndërsa për pretendimin për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë tej afatit të arsyeshëm ligjor, Gjykata do të analizojë nëse kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

28. Gjykata thekson se në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt mosgjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, edhe kur legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Me ligjin nr. 38/2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile” u shtuan dispozita të reja për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në datën 5.11.2017, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përsheptimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 15.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata rithekson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim janë efektive (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, ajo mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret, ndryshimet e reja të KPC-së kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017, pra rreth 4 vjet përpara dhënies së vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në datën 23.11.2021, çka do të thotë se kërkuesi ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për t’u njohur me këto ndryshime dhe për të shfrytëzuar mjetet e reja ligjore për të kërkuar përsheptimin e gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se argumenti i kërkuetit se Gjykata e Lartë është konfirmuar si mjet joefektiv nuk qëndron dhe në rrethanat kur ai nuk ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e

shqyrtimit të rekursit, nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për përshejtimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë.

33. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Kolegji vëren se shkronja “b” e pikës 1 të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuksi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë në datën 9.3.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

34. Kërkuksi në përmbajtje të kërkesës, ndër të tjera, ka parashtruar, se: “*është detyrë funksionale e Gjykatës që përpara së të shqyrtojë çdo pretendim tjetër procedural ose material, duhet të vendosë nëse vetë është zgjedhur në përputhje me ligjin*”. Për këtë parashtrim, Gjykata rithekson se për mënyrën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues procedurat janë kryer në përputhje me formulën kushtetuese të parashikuar në nenin 125 të Kushtetutës, sipas ndryshimeve kushtetuese të miratuara në vitin 2016, zbërthyer më tej në dispozitat e ligjit nr. 8577/2000 (*sib vendimin nr. 1, datë 16.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se është kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur për çështjen në gjykim.

35. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuksi ka parashtruar se si rezultat i zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë është cenuar edhe e drejta e pronësisë, e mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas tij, në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1, në vlerësimin e së drejtës së pronësisë, GJEDNJ-ja ka pranuar se nocioni “pasuri” nuk kufizohet vetëm te “pasuritë ekzistuese”. Nën këtë nocion janë edhe asete të tjera, përfshirë pretendimet nëpërmjet të cilave aplikanti mund të argumentojë se ka të paktën një “pritshmëri legjitime” (e cila duhet të ketë karakter më konkret se sa thjesht një shpresë) se ato do të realizohen. Pronësia përfshin të drejtat *in rem* dhe *in personam*, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe interesat e tjera pronësore.

36. Në rastin konkret, e drejta e pronësisë lidhet me një shumë të caktuar të hollash, të cilat konsiderohen se janë pjesë e pasurisë së tij. Në rrethanat kur kërkuksi pretendimin për cenimin e së drejtës së pronësisë e ka lidhur ngushtësisht me procesin e rregullt ligjor, Gjykata vëren se sipas nenit 42 të Kushtetutës për të përcaktuar nëse është cenuar e drejta e pronësisë, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, e cila ka dhënë vendimin që kundërshtohet nga kërkuksi, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor. Në vijim, Gjykata do të analizojë pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike

37. Kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërkit kryesor nëse ai ishte debitor kundrejt shoqërisë huamarrëse “Vefa Holding” sh.p.k. (nën administrim). Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në aspekt të respektimit të *res judicata*, pasi mosmarrëveshja mes palëve është zgjidhur me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për të cilin Gjykata e Lartë nuk shprehet në vendim. Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat më të ulëta u provua se kërkuksi është pronar i shumës 5.100.000 USD, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, i ka mohuar titullin e pronësisë mbi këtë shumë.

38. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Lidhur me parimin e sigurisë juridike, në këndvështrim të *res judicata*, procesi gjyqësor i referuar nga kërkuksi nuk trajton të njëjtën marrëdhënie juridike, madje nuk mbart të njëjtën natyrë juridike me çështjen konkrete. Për pretendimin e cenimit të pronësisë, kërkuksi merr të mirëqena pretendimet e tij të paraqitura në

gjykatat e faktit, ndërkohë që çështja e tij, bashkë me pretendimet, është rrëzuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

39. Subjekti i interesuar, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i bazuar në prova dhe ka respektuar ligjin material e procedural.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 23, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, zbatimi i standardit të arsytimit të vendimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 71, datë 30.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 41, datë 6.7.2016; nr. 21, datë 16.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata e ka vlerësuar gjënë e gjykuar si pjesë të sigurisë juridike dhe të lidhur me procesin e rregullt. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Sikurse u parashtua, Gjykata vëren se gjatë viteve mes kërkuesit dhe administratorëve të shoqërisë në administrim janë zhvilluar disa procese gjyqësore (*shih paragrafët 3-18 të këtij vendimi*). Në procesin gjyqësor civil të përfunduar me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shqyrtuar padia e paraqitur nga administratorët e shoqërisë nën administrim me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të 13 kontratave të shitblerjes të lidhura në datën

2.12.1996 mes kërkuarit (shitësi) dhe shoqërisë huamarrëse (blerësi) për çmimin total 11.160.000 USD.

46. Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë Përmet, me vendimin nr. 289, datë 1.10.2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të paraqitur nga administratorët e shoqërisë nën administrim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 247, datë 28.5.2002, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar, se: “... të gjithë objektet e mësipërme të paditurit i kanë privatizuar nga shteti në muajin tetor 1996 kundrejt vlerave tepër të ulëta në krahasim me çmimin e shitjes së tyre shoqërisë “Vefa”. Administratorët e kësaj të fundit, bazuar në ligjin nr. 8472, datë 8.4.1999 ..., nenet 1, 2, 3 dhe 4 si dhe nenin 92/b të K. Civil kanë kërkuar që të gjithë kontratat e mësipërme të konstatohen të pavlefshme dhe të paditurit të kthejnë diferencën midis çmimit të shitjes dhe çmimit me të cilin objektet janë privatizuar dhe figurojnë të regjistruara në Zyrën e Hipotekës. Kjo diferencë sipas përlllogaritjeve të palës paditëse është 7.828.811 USD./Në kohën që padia është ngritur ka qenë në fuqi neni 3 i ligjit 8472, i cili parashikonte shprehimisht: “Personat fizikë dhe juridikë, vendas a të huaj, të cilët, nëpërmjet fitimit të pronësisë nga privatizimi apo me mënyra të tjera, kanë përfituar vlera financiare a pasurore nga subjektet e kontrollit a personat e lidhur me ta, nëpërmjet kryerjes së veprimeve juridike të shitjes së pronave me çmime më të larta se çmimi i privatizimit apo se çmimi mesatar përkatës i shitjes në tregun e lirë, detyrohen t’ia kthejnë ato administratorëve të shoqërive huamarrëse”. Kjo dispozitë nuk linte vend për interpretime, pasi mjafton të vërtetohet fakti i lidhjes së kontratave midis subjekteve që ai parashikon në kushtet e një shpërpjesëtimi të dukshëm në çmim, që personat përfitues të këtyre vlerave t’i kthenin ato pranë shoqërisë huamarrëse./Megjithëse kjo dispozitë ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit në gjykatën e rrethit, kjo gjykatë në vendimin e saj nuk i ka marrë parasysh urdhërimet e saj, duke dhënë edhe argumentet pse ajo nuk duhet zbatuar apriori vetëm për shkak të diferencës së dukshme të çmimit të shitjes nga ai i privatizimit. Sipas saj kontratat janë lidhur me vullnetin e të dy palëve, pa shkelur asnjë ligj të kohës dhe çmimi i vendosur në to ka qenë ai i pranuar po me vullnet të lirë. Vetëm ky fakt, sipas saj, nuk mund të përbëjë shkak për pavlefshmëri bazuar në ligjin nr. 8472 të vitit 1999. Për sa më sipër ajo ka rrëzuar padinë e palës paditëse./Situata ka ndryshuar në kohën e zhvillimit të gjykimit pranë gjykatës së apelit. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 40, datë 11.3.2002 ka shfuqizuar si antikushtetues nenin 3 të ligjit të mësipërm, duke mbetur ai në fuqi për pjesët e tjera. Megjithëse në kushte të reja të krijuar mbas dhënies së këtij vendimi, pala paditëse ka vazhduar t’i qëndrojë pretendimit të saj se vetëm për shkak të diferencës së çmimit kontratat duhet të konstatoheshin të pavlefshme./Gjykata e apelit ka rrëzuar këtë pretendim me argumentet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e mësipërm, dhe ka konkluduar se vetëm për këtë shkak nuk mund të konstatohen të pavlefshme kontratat. Por duke qenë se padia ka pasur si shkak ligjor edhe nenin 92/b të K. Civil, ajo mbasi i ka bërë një analizë të hollësishme të të gjitha pretendimeve të palës paditëse, ka arritur në konkluzionin se, kjo e fundit, nuk ka mundur të provojë se në mashtrim me cilin ligj apo dispozitë janë kryer veprimet e shitblerjes së objekteve të mësipërme. Për sa më sipër ajo ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit./Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludoi se vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit është i drejtë e i bazuar në ligj./Siç u theksua edhe më lart ka rezultuar se në situatën e re të krijuar mbas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të nenit 3 të ligjit nr. 8472, pala paditëse nuk ka bërë asnjë ndryshim apo plotësim të shkaqeve të parashtruara në kërkesëpadi lidhur me atë se përse kërkohet pavlefshmëria e kontratave. Ajo si gjatë gjykimit dhe në rekursin e paraqitur ka vazhduar të pretendojë se shkak i vetëm për pavlefshmëri është shpërpjesëtimi i dukshëm në çmimin e shitjes me atë të privatizimit. / Me të drejtë gjykata e apelit arsyeton se, vetëm ky fakt nuk përbën shkak për pavlefshmëri të kontratave, pasi gjithë arsyetimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese i referohet lirisë kontraktore të palëve në ekonominë e tregut dhe nuk e konsideron atë si shkak për pavlefshmëri sikundër parashikonte më parë kjo dispozitë. / Është e vërtetë se ligji për pjesët e tjera ka mbetur në fuqi, por dispozitat në vijim nuk bëjnë ndonjë parashikim të posaçëm në trajtim të diferencuar të veprimeve juridike të kryera nga subjektet e kontrollit me personat fizikë dhe juridikë apo personat e lidhur me ta, ndryshe nga ai që bën Kodi Civil. Përkundrazi neni 4 i këtij ligji parashikon ... Pra, për çdo rast tjetër edhe në rastet e veprimeve juridike të kryera me subjektet e kontrollit ky ligj

referon në Kodin Civil. / Pala paditëse nuk arriti të provojë kryerjen e veprimit juridik në mashtrim të ligjit sipas nenit 92/b të K. Civil, sepse nuk vërtetoi në mashtrim me cilin ligj janë lidhur këto kontrata. Siç theksuam përfaqësuesi i palës paditëse gjatë gjykimit dhe në rekursin e paraqitur pretendoi se mashtrimi i ligjit konsiston në shitjen me çmim më të lartë se ai i privatizimit, pretendim ky i pabazuar për sa është argumentuar më lart.”. Në vendim ajo ka arsyetuar: “Pala paditëse kërkon të merret si e mirëqenë si shumë e përfituar nga të paditurit vlera totale e objekteve të shitura, pasi nëpër kontratat e shitjes është shkruar “shuma e vlerës së shitjes është likuiduar totalisht jashtë zyrës së noterit”, kurse pala e paditur e kundërshton me argumentimin e saj se të gjitha këto kontrata janë tip dhe kanë të njëjtën shprehje standarde dhe dubet interpretuar kjo shprehje në kuptim të qëllimit që kishin palët për të kryer veprimin para noterit, me qëllim që të realizohet kontrata në formën e kërkuar nga ligji. Gjykata konkludon se kur interpretojmë një kontratë në kuptim të neneve 681 e vijuese të Kodit Civil dubet të merret parasysh qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve...i cili në këtë rast ka qenë përfundimi i kontratës. Është e pamundur për t’u provuar se një lëvizje në vlera monetare në shumën të tilla të konsiderueshme të jetë bërë pa firmë shkresore, aq më tepër lëvizje nëpërmjet një personi juridik drejt një personi tjetër fizik (apo juridik). Nuk mund të provojmë se gjendja kontabël e firmës “Vefa” ka ndryshuar apo jo para hartimit të kontratave para noteres Shpresa Kurti më datë 2.12.1996. Fakti që pala e paditur nuk ka kërkuar prej firmës “Vefa” shumën tjetër që ngelet për t’u marrë prej saj që ngelet nga diferenca 5.100.000 kundrejt shumës së shitjes nuk e bën këtë të drejtë me efekt dekadence, megjithëse kanë kaluar 5 vjet, siç përmend në diskutimin e saj pala e paditur, pasi kjo firmë është në proces administrimi. Gjykata gjatë hetimit gjyqësor të kësaj çështje ka pasur dhe ka parasysh qëllimin e mirë të ligjit nr. 8472, datë 8.4.1999, retrospektivën e ngjarjeve të vitit 1997 dhe efektin parandalues për firmat piramidale, por njëkohësisht në mbështetje të jurisprudencës dhe legjislacionit tonë nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore, e cila për efekt të çmimit të papërshtatshëm (n.q.s. do të konsiderohet i tillë duke u eliminuar parimi i lirisë kontraktore të palëve) të bëhet shkak për pavlefshmëri të veprimit juridik. Akoma ligjvënësi nuk ka vendosur një dispozitë të tillë ndaluese, përderisa nuk u provua në seancë se palët kanë vepruar në mashtrim të ligjit dhe si e tillë mbështetur në provat e paraqitura nga palët gjatë hetimit gjyqësor duke ju referuar dhe dispozitave ligjore dhe normave të tjera në fuqi arrin në konkluzionin përfundimtar se padia dubet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova.” (shih faqet 5 dhe 6 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet).”.

47. Në rastin objekt shqyrtimi në gjykimin kushtetues, Gjykata vëren se mes palëve është krijuar një mosmarrëveshje juridiko-administrative me objekt deklarimin të pavlefshëm të titullit ekzekutiv nga vendimi nr. 392, datë 9.7.2004 i administratorëve të shoqërisë nën administrim, proces që ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-1768 (251), datë 23.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Gjykata vlerëson se pavarësisht se *prima facie* proceset gjyqësore u përkasin të njëjtave palë, në thelb, ato kanë objekt dhe shkak të ndryshëm ligjor. Për rrjedhojë, vendimi nr. 1319, datë 21.11.2007 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk përbën “gjë të gjykuar”.

48. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve, duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 56, datë 19.7.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Më konkretisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka argumentuar qëndrimin e tij bazuar në ligjin nr. 8471/1999, si një ligj specifik, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar mes palëve, i cili ka vendosur rregulla për arkëtimin e detyrimeve debitore dhe rikthimin e vlerave financiare dhe pasurive të tjetërsuara nga të tretët pranë shoqërive nën administrim, me qëllim shlyerjen në mënyrë të kënaqshme të interesave të të gjithë kreditorëve, ku, në mënyrë të posaçme, i ka dhënë vendimeve të administratorëve të shoqërive, kundrejt debitorëve të identifikuar në përputhje me parashikimet e ligjit, statusin e titujve ekzekutivë. Gjithashtu, në ligj janë parashikuar afate shumë të shkurtra për vjeljen e detyrimeve, si dhe afate për kundërshtimin e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv, si në rastin në shqyrtim, ashtu edhe për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8471/1999 dhe në rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative për njoftimin e akteve administrative, ka arsyetuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka

interpretuar keq ligjin material të zbatueshëm në rastin konkret, duke mos zbatuar dispozitat e posaçme të ligjit për parashkrimin e padisë, ndërsa ka arritur në përfundimin se padia e kërkuarit ishte ngritur dukshëm jashtë afatit ligjor 10-ditor, çka passillte parashkrimin e së drejtës së padisë, domethënë humbjen/shuarjen e saj dhe pamundësinë e realizimit me anë të gjykatës. Ky konkluzion ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimit përfundimtar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

49. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar t'i japë përgjigje edhe shkakut të ngritur në rekurs lidhur me ekzistencën e detyrimit objekt gjykimi, duke arsyetuar se *“Gjykata e Apelit Tiranë ka zbatuar keq ligjin material dhe atë procedural, gjë që ka ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit, sa i takon ekzistencës së detyrimit mes palëve. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se vlera e detyrimit për të cilin është shpallur debitor paditësi nuk është e padokumentuar, pasur në vlerësim vetëm përmbajtjen e vendimit penal nr. 1292, datë 28.12.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në atë gjykim, paditësi është gjykuar për veprën penale të parashikuar nga neni 287/1, shkronja b) të Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, duke u shpallur i pafajshëm, vendim ky i cili është lënë në fuqi, gjatë rigjykimit, nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 533, datë 29.6.2007. Në këtë vendim, i cili ka shërbyer nga Gjykata e Apelit Tiranë për të konkluduar mbi mosekzistencën e detyrimeve mes palëve, përshkruhet se vlera e detyrimit objekt gjykimi është shlyer me urdhër xhirimi të datës 27.12.2007, për efekt të disa kontratave shitje që janë realizuar mes palëve. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se prezumimi i vërtetësisë së një fakti që sjell lindjen e të drejtave dhe detyrimeve civile, i cili ka rezultuar në përmbajtjen e një vendimi penal, gjatë një procesi gjyqësor penal të pavarur, nuk mund të ketë efekt detyrues dhe as të prezumojë ekzistencën e faktit, për efekte të një procesi tjetër gjyqësor civil. Interpretimi a contrario, sikurse ka ndodhur në rastin konkret, përbën shkelje të rëndë të ligjit, e cila dukshëm ka ndikuar në dhënien e vendimit përfundimtar. Kolegji sjell në vëmendje se neni 70 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër.” (shih paragrafët 28–29 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

50. Për sa më lart, Gjykata çmon se vendimi nr. 1319, datë 21.11.2007, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk përbën *res judicata* për mosmarrëveshjen juridiko-administrative të krijuar mes palëve, për rrjedhojë fakti që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka përmendur, nuk përbën mangësi thelbësore në arsyetimin e vendimit. Vendimi i kundërshtuar nga kërkuari rezulton të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, duke përmbushur standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me parimin e sigurisë juridike.

51. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e parimit të paanshmërisë

52. Kërkuari ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi çështja është shqyrtuar pas një periudhe shumë të gjatë dhe është zgjidhur në një kohë shumë të shkurtër, duke cenuar aspektin subjektiv të paanshmërisë. Gjithashtu, në kushtet kur gjykata nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e njoftimit të parashikuara nga KPC-ja, është cenuar edhe aspekti objektiv.

53. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkuari nuk ka paraqitur argumente. Vonesat në gjykim dhe marrja e vendimit në vetëm një seancë në dhomë këshillimi nuk janë argumente që ndikojnë në parimin e paanshmërisë.

54. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në

mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 6, datë 29.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur prova për të mbështetur pretendimin e tij. Periudha e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk është fakt i mjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për paanshmëri në kuptimin subjektiv. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata vlerëson se edhe në këtë drejtim kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur këtë pretendim për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes.

56. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e këtij parimi në aspektin objektiv ose subjektiv të tij, për rrjedhojë edhe ky pretendim është i pabazuar.

B.3. Për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur

57. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit dhe për t'u dëgjuar, pasi nuk e ka gjykuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata e Lartë, duke zhvilluar gjykimin në dhomë këshillimi, nuk i ka krijuar mundësi kërkuetit të parashtojë pretendimet e tij, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Gjykata e Lartë e ka kryer njoftimin vetëm me shpallje për kërkuetin, por kjo nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin.

58. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se në parim është absurde të pretendohet se gjykimi në dhomë këshillimi, si proces, mund të përbëjë pengesë në raport me aksesin e subjektit në gjykatë. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë se pse Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore. Pretendimi se shqyrtimi i çështjes pas 8 vjetësh në dhomë këshillimi është shkelje, nuk gjen bazë ligjore në asnjë dispozitë dhe nuk mbart sens juridik. Kërkuesi nuk ka pretenduar në asnjë moment se nuk i është njoftuar rekursi, por ngre pretendime për paligjshmërinë e veprimeve të sekretarisë gjyqësore në raport me faktin se ka kryer vetëm njoftim publik për çështjen konkrete.

59. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Për të drejtën e ankimit, Gjykata është shprehur se shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në

kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, mungesa e një seance në një gjykatë të shkallës së dytë ose të tretë mund të justifikohet me veçoritë e procedurave, me kusht që në shkallë të parë të jetë zhvilluar një seancë dëgjimore (*shih vendimin në çështjen Helmers kundër Suedisë, § 36 dhe a contrario, §§ 38–39*). Kështu, procedurat që kanë të bëjnë me të drejtën për të paraqitur ankim dhe ato që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, në dallim nga ato të faktit, mund të pajtohen me kërkesat e nenit 6 edhe pse ankuesit nuk i është dhënë mundësia të dëgjohet personalisht nga një gjykatë apeli ose kasacioni (*po aty, §30*). Ndaj duhet të mbahen parasysht veçoritë e procedurave në gjykatat më të larta.

61. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 11.10.2012 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 36, datë 10.3.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit Tiranë, në rigjykim, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë të paraqitur nga kërkuesi (*shih paragrafin 18 të këtij vendimi*). Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs administratorët e shoqërisë nën administrim, si dhe Avokatura e Shtetit.

62. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se në përputhje me nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2002, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), çështja është publikuar në shpalljet e datës 25.10.2021, ku njoftohej se seanca do të zhvillohej në dhomë këshillimi në datën 15.11.2021, në orën 10:00. Sipas nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomë këshillimi. Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 15.11.2021 rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes.

63. Duke mbajtur në konsideratë që Gjykata e Lartë sipas Kushtetutës vepron si gjykatë ligji (pra nuk merret me shqyrtim provash, dëgjim dëshmitarësh dhe përcaktim faktesh), Gjykata vlerëson se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të jenë cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe duke pasur parasysht gjykimin e zhvilluar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, kërkuesit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se edhe në tërësi procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë në një shkallë gjykimi (në gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesi ka qenë i përfaqësuar me avokat, duke i krijuar mundësinë për t’u dëgjuar dhe mbrojtur.

64. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur është i pabazuar.

B.6. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

65. Kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë, duke gjykuar në dhomë këshillimi, nuk ka marrë në shqyrtim aktet e administruara në cilësinë e provës shkresore, akte që vërtetojnë se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm. Kërkuesi është vënë në një situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykata ka vendosur vetëm për pretendimet e palës së paditur, pa i dhënë mundësi kërkuesit të parashtrojë prapësime.

66. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar. Sekretaria gjyqësore ka kryer njoftimin përkatës nëpërmjet shpalljes publike për zhvillimin e çështjes në dhomë këshillimi. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka vendosur duke u bazuar vetëm te pretendimet e njëres palë është paragjykes, pasi pretendimet i shërbejnë gjykatës për dhënien e vendimit, por nuk mund të aludohet se ajo ka vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të njëres palë.

67. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislati procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

68. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

69. Në çështjen konkrete, sikurse u parashtrua edhe në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit në dhomën e këshillimit i ka siguruar kërkuarit mundësi të barabarta me palët e tjera për të parashtruar argumentet dhe provat në mbrojtje të interesave të tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e parimit barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar.

70. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuari për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor është e pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronësisë të pretenduar prej tij është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.11.2022.

Shpallur më 5.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Altin Binaj, Ilir Toska